



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 56

Prishtinë, më 20 maj 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi, Petar Miletij.

Munguan: Enis Kervan, Berat Buzhala .

Në mbledhje ishte i pranishëm ministri i Ministrisë së Diasporës z. Ibrahim Makolli, sipas ftesës së Komisionit dhe pjesëtarë të kabinetit të tij.

Pjesëmarrës të tjerë: Besim Berisha-Ministria e Diasporës, Besnik Ramadani-KDI, Shefki Kastrati-NDI, Bardhyl Meta-OEGJ dhe mediat.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Gurjeta Zeka, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 2, 10 dhe 17 prill 2013;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës z. Ibrahim Makolli;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 2, 10 dhe 17 prill 2013;

Kryetari konstatoi se, Komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura me 2, 10 dhe 17 prill 2013.

3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës z. Ibrahim Makolli;

Albin Kurti, çmoi gatishmërinë e ministrit Makolli për përgjigje pozitive, në ftesën e Komisionit që të raportojë lidhur me aktivitetet dhe angazhimet e Ministrisë së Diasporës, nga fillimi i këtij viti e deri më tash.

Ibrahim Makolli, gjatë raportimit të tij, theksoi se një ndër objektivat kryesore të aktiviteteve të Ministrisë së Diasporës gjatë kësaj periudhe, ka qenë hartimi i Strategjisë për diasporën dhe mërgatën. Ai njoftoi për angazhimin ministrisë, në hartimin e kësaj strategjie, ndihmën dhe konsultat e zhvilluara me përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Makolli tha se tani gjenden në fazën përfundimtare të hartimit të Strategjisë dhe se së shpejti, kjo Strategji do të dërgohet në Qeveri për miratim.

Objektiv i dytë për Ministrinë e Diasporës, tha se ka qenë hartimi i regjistrit të mërgatës, për të cilin dokument njoftoi se po ashtu janë konsultuar me aktorë të shumtë vendorë e ndërkombëtarë. Për koncept dokumente të regjistrit të mërgatës, njoftoi se është formuar komisioni, i cili i ka ofruar tri modalitete për hartimin e këtij dokumenti.

Objektiv i ministrisë në vazhdimësi tha se është institucionalizimi i mësimit plotësues. Lidhur me këtë, ministri Makolli njoftoi për organizimin e Konferencës Kombëtare në vitin 2012, me përfaqësues të MASHT-it të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme, përfaqësues të institucioneve nga Lugina e Preshevës, Mali i Zi dhe Maqedonia. Nga kjo konferencë tha se kanë dalë pesë objektiva dhe janë formuar grupet punuese, të cilat në vazhdimësi po veprojnë rreth hartimit të dokumentacionit për një qasje të përbashkët dhe të njëjtë nga gjithë hapësirat shqiptare, në raport me mësimin plotësues në diasporë.

Ministri Makolli, në vazhdim njoftoi edhe për hapjen e qendrës kulturore në Turqi, përgatitjet për hapjen e qendrës kulturore në SHBA dhe për fillimin e procedurave për hapjen e qendrave kulturore edhe në Gjermani e në Francë. Aktivitet tjetër të ministrisë, theksoi fillimin e grumbullimit të materialit muzeor dhe atij arkivor dhe sjelljen e tij në Kosovë, për të cilën çështje tha se ka bashkëpunim edhe me Muzeun dhe Arkivin e Kosovës. Ministri njoftoi edhe për angazhimet e ministrisë, lidhur me aktivitetet kulturore të diasporës, siç është organizimi i ditëve të mërgatës, organizimin e hulumtimit për mbijetesën gjuhësore, kulturore dhe pozitën e mërgatës në vendet ku ka koncentrim më të madh të saj, hulumtimin e legjislacionit dhe propozimin e politikave për krijimin e një klime më të mirë të investimeve nga mërgata. Duke pasur parasysh se Kosova nuk ka përfaqësi diplomatike në secilin shtet ku jeton mërgata jonë, Makolli njoftoi për kërkesën e mërgimtarëve për t'u pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në vendet ku ata jetojnë, përmes shërbimeve tona lëvizëse.

Albin Kurti, duke u ndërlidhur me aktivitetet e Ministrisë së Diasporës dhe raportimin e ministrit Makolli, i ngriti disa çështje nga fushëveprimi i kësaj ministrie, për të cilat kërkoi të informohet nga ministri për pyetjet në vijim: Çfarë politika janë aplikuar deri më tani, për të nxitur investimet nga mërgata, dhe sa keni arritur të keni sukses? A është rritur numri i investimeve në vend nga mërgata? A ka përmirësim sa i përket furnizimit të bashkatdhetarëve me dokumente përkatëse? Cili është qëndrimi dhe angazhimi juaj për çështjen e dyshtetësisë? Çfarë keni bërë deri më tani që të krijoni ndonjë program për t'i inkuadruar mërgimtarët e kualifikuar në proceset zhvillimore të Kosovës, në mënyrë që Kosova të përfitojë nga përvojat e tyre si një mundësi e mirë për zhvillim politik,

ekonomik dhe social të Kosovës? Sipas raportit, Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën, është paraparë të bëhet në tremujorin e parë dhe të dytë. Meqë jemi në mesin e majit, pra fundit të tremujorit të dytë, deri ku kanë arritur punët dhe kur do e sillni këtë dokument para Komisionit?

Çfarë keni bërë për t'i lehtësuar mërgimtarët nga pagesat e larta të sigurimeve? Pse nuk është bërë regjistrimi i diasporës deri më tani dhe kur mendoni se do ta bëni këtë? Deri ku keni arritur me regjistrimin e diasporës në kuptimin sasiorë? Çfarë hapa keni ndërmarrë për të filluar bashkëpunimin me mërgatën në fushën e shkencës dhe zhvillimit të teknologjisë?

Në përgatitje të zgjedhjeve nacionale, mërgimtarët interesohen për procedurat e votimit. A jeni duke punuar në këtë drejtim dhe çfarë do të ndryshojë nga zgjedhjet e vitit 2010?

Sa qendra kulturore keni hapur deri më tani, raporti thotë kuartali 1-4 parashihen Zvicra, Gjermania, Franca dhe SHBA-ja. Kush i drejton ato? Me se jam në dijeni, në Paris dhe Stamboll janë hapur, janë zgjedhur edhe drejtorët. Si i keni zgjedhur drejtorët, pasi që nuk është miratuar Rregullorja për zgjedhjen e drejtorit të Qendrës Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe mërgatën?

A jeni në dijeni se më 28 qershor 2012, Austria ka suspenduar marrëveshjen sociale me Kosovën? Nëse po, a e keni biseduar këtë çështje me ministrin e Punëve të Jashtme Hoxhaj, dhe a e keni ngritur ju personalisht këtë shqetësim në takimet tuaja me zyrtarët austriakë?

Çfarë është bërë për çështjen e pensioneve të shqiptarëve në Zvicër që po trajtohen gati si emigrantë?

Në raport thuhet se janë blerë 6.000 libra dhe literatura shkollore. Kush dhe si i përzgjedhi ato?

Sa i përket Konferencës me mjekë të huaj, cilat janë të arritura nga kjo konferencë? Si do të ndikojë kjo në përmirësimin e sistemit aktual shëndetësor në Kosovë? A ka ndonjë plan që parasheh një gjë të tillë, duke përfshirë afatet kohore?

A është themeluar departamenti ligjor i Ministrisë së Diasporës? Nëse është ekzistues ky departament cila është arsyeshmëria e shpenzimit të shumës 50.000 euro, për hartimin e dokumentit për Regjistrin e mërgimtarëve, dhe e Rregullores për strukturën, organizimin dhe funksionimin e qendrave kulturore të Kosovës për diasporën dhe mërgatën, me kosto 3.000 euro dhe Rregullores për zgjedhjen e drejtorit të Qendrës Kulturore të Kosovës për Diasporën dhe Mërgatën, me kosto prej 2.000 euro? Cila është arsyeshmëria e nxjerrjes së Rregullores për zgjedhjen e drejtorit të qendrave kulturore, kur kjo çështje mund të rregullohet me Rregulloren për Strukturën, Organizimin dhe Funksionimin e Qendrave?

Hydajet Hyseni, vlerësoi punën e bërë nga Ministria e Diasporës, të cilën e konsideroi shumë të rëndësishme, punë e cila tha ky se e justifikon themelimin e kësaj ministrie të posaçme për diasporën. Megjithatë, theksoi se angazhimet e Ministrisë së Diasporës në të ardhmen, duhet të pasurohen dhe të plotësohen dhe të gjendet mundësia e bashkëveprimit për çështjet dhe rolin e mërgatës. Ai shtroi edhe disa nga vështirësitë me të cilat përballet mërgata jonë posa të arrij në atdhe. Roli i mërgatës, tha se do të duhej të vlerësohej edhe më shumë, duke filluar nga e kaluara, që është një ngjarje e rëndësishme, jo vetëm për historinë e mërgatës por për gjithë lëvizjen tonë. Po ashtu theksoi nevojën e një angazhimi më të madh të ministrisë për përkujdesjen ndaj pjesës së komuniteteve të Kosovës, që jetojnë jashtë kufijve të Kosovës, në fqinjësi. Hyseni e konsideron obligim të Ministrisë së Diasporës, që të adresojë çështjen e shqiptarëve të Preshevës e Bujanocit, të cilët dënohen për të ardhur e komunikuar lirshëm, gjë që nuk vlen për pjesëtarët e komuniteteve të tjera.

Skender Hyseni, përgëzoi ministrin Ibrahim Makolli, për punën e mirë të bërë deri më tani në Ministrinë e Diasporës dhe i ndau shqetësimet me ministrin, lidhur me çështjet e ngritura nga ai. Ai kërkoi të informohet nga ministri, se sa është e koordinuar Ministria e Diasporës me dikastere të

tjerë qeveritarë të politikës së jashtme, si në fushën e investimeve ashtu edhe në atë të shërbimeve të jashtme. A ka dublikim të veprimeve që si pasojë e tyre të mungojnë rezultatet.

Duke përkujtuar se MPJ, për dy vite e gjysmë ka hapur vetëm një zyrë konsullore në Strasburg, pyeti ministrin Makolli se pse nuk ka insistuar në hapjen e njërive themelore për nevoja të qytetarëve tanë në Nju-Jork, Toronto ose në Otavë të Kanadasë.

Hyseni, theksoi si shumë të rëndësishme, mundësinë e shfrytëzimit të shkollimit cilësor të mërgimtarëve tanë në universitetet ku ata qëndrojnë si dhe nevojën për investime të diasporës në Kosovë, kryesisht në prodhim, në industri të vogël dhe të mesme.

Donika Kadaj-Bujupi, shtroi çështjen e pensioneve të punëtorëve të Zvicrës, për të cilën tha se është trajtuar mjaft, është biseduar edhe me një delegacion nga Zvicra, i cili ka qenë në takim me Komisionin, mirëpo, ende nuk është zgjidhur problemi i tyre.

Ajo, kërkoi të informohet nga ministri se a ka ndonjë lëvizje pozitive në këtë drejtim dhe cilat janë angazhimet e Ministrisë së Diasporës, që kjo çështje përfundimisht të marrë zgjidhjen e duhur.

Emilija Rexhepi, në diskutimin e saj në mes tjerash kërkoi të informohet nga ministri, lidhur me strategjinë e ministrisë për kthimin e qytetarëve tanë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare, si dhe për strategjinë e sjelljes së investitorëve tanë, të cilët dëshirojnë të investojnë në Kosovë.

Ibrahim Makolli, lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit, njoftoi se të hyrat të cilat sjellën nga mërgata, përdoren kryesisht për konsum e jo për investime ekonomike.

Ministria e Diasporës, ka një bashkëpunim të mirë me dikastere të tjerë, të cilët merren me çështjet e investimeve, dhe atyre u është ofruar një dokument me politikën, për të cilat mendohet se do të ndikojnë drejtpërdrejtë në krijimin e një klime më të mirë për investime në Kosovë. Makolli njoftoi se në shkurt të këtij viti, është organizuar një takim me rreth 200 investitorë nga mërgata, prej të cilëve është marrë opinioni i tyre lidhur me legjislacionin në Kosovë në fushën e investimeve. Nga mërgimtarët ka të interesuar, për të investuar në prodhim në Kosovë dhe vërehet interesimi i tyre për të pasur politika më të favorshme për investime. Ka përmirësim të ofrimit të shërbimeve për bashkatdhetarët tanë për dokumente, por ndihet mungesa e përfaqësive diplomatike në vende të ndryshme, që e vështirëson plotësimin e nevojave të bashkatdhetarëve për shërbimet e tyre. Në këtë drejtim, ai tha se i janë drejtuar MPJ-së, për gjetjen e një zgjidhjeje, duke hapur përfaqësi konsullore apo mundësi të ofrimit të shërbimeve lëvizëse.

Sa i përket dyshtetësisë, Makolli theksoi se një numër i madh i shtetasve tanë heqin dorë nga nënshtetësia e Kosovës, për shkak se disa nga shtetet ku ata jetojnë nuk u lejohet dyshtetësia. Në takimet me autoritetet e ndryshme, lidhur me çështjen e dyshtetësisë, njoftoi se nuk kanë mund të kenë ndikim më arsyetimet e tyre se nuk mund t'i ndryshojnë ligjet e tyre, për nevojat e të tjerëve.

Sa i përket programit për inkadrimin e mërgimtarëve të kualifikuar në proceset zhvillimore të Kosovës, një nga ato, tha se është edhe konferenca me mjekët shqiptarë dhe se në këtë drejtim do të insistojnë në vazhdimësi, që numri i njerëzve të kualifikuar dhe që kanë mundësi të jenë në funksion të proceseve zhvillimore të vendit tonë të shtohet.

Lidhur me përfundimin e dokumentit të Strategjisë për diasporën dhe mërgatën, njoftoi se është planifikuar që ky dokument të kalojë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, në fund të muajit qershor të këtij viti. Pagesën e taksës së sigurisë për mërgimtarët e konsideron të padrejtë dhe në takimet me autoritetet për heqjen apo zvogëlimin e kësaj takse, tha se nuk kanë hasur në mirëkuptim.

Sa i përket hartimit të regjistrit të mërgatës, Makolli tha se ky proces do të fillojë këtë vit dhe në bazë të parashikimeve të komisionit përkatës, Kosova do ta ketë regjistrin në fund të vitit 2014, eventualisht në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.

Ministri Makolli, njoftoi se mërgimtarët janë të interesuar për të qenë pjesë e votimeve në Kosovë dhe kemi kërkuar edhe nga dikastere të tjerë, që mërgatës t'i krijohen kushte për të votuar në vendin ku ata jetojnë.

Lidhur me suspendimin e marrëveshjes sociale të Austrisë, ai njoftoi se është biseduar me ministrin Hoxhaj dhe me autoritetet e shtetit austriak, dhe pritet që këto marrëveshje të ripërtërihen. Po ashtu, tha se jemi pjesë e grupeve punuese sa i përket çështjes së pensioneve problematike me Zvicrën, dhe në rrugë të mbarë për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Blerja e librave dhe lekturave, të aprovuara për klasën e parë deri në të nëntën për nevojat e mërgimtarëve, tha se është bërë në bazë të interesimit të mërgatës dhe ato janë blerë përmes tenderit. Gjithë dokumentacionin lidhur me regjistrimin e mërgatës, të specifikuar me veprimet dhe shpenzimet që parashihen të bëhen gjatë këtij procesi, tha se mund të ja përcjellim KPJ-së.

Makolli njoftoi se në kuadër të Ministrisë së Diasporës, ekziston departamenti ligjor, ndërsa kostoja e shpenzimeve për hartimin e dokumentacionit është paraparë në rast të nevojave për organizimin e dëgjimeve publike, e angazhim të ekspertëve. Ai njoftoi se deri më tani për dokumentet e përfunduara, nuk ka pasur asnjë shpenzim. Ministri tha se i inkurajojnë mërgimtarët tanë që fëmijët t'i shkollojnë në universitetet ku ata jetojnë, dhe në raport me vitet e kaluara vërehet një interesim më i madh i tyre për shkollim të lartë në vendet ku ata jetojnë. Sa i përket bashkëpunimit me dikastere të tjerë, tha se MD-ja ka bashkëpunim me dikastere të tjerë dhe nuk ka veprime të njëjta nga autoritetet e ndryshme. Lidhur me shqiptarët në Luginën e Preshevës, të cilën e shtroi deputeti Hydajet Hyseni, ministri theksoi kjo çështje nuk i takon MD-së dhe nuk mund të ketë ndikim në të. Ajo çështje varet nga dikastere të tjerë.

Ministri njoftoi se nga MD-ja po ndërmerren veprime për t'i përkrahur edhe mërgimtarët nga Kosova të komunitetit boshnjakë, rom, ashkali dhe të gjitha komunitetet e tjera, sepse janë pjesë e mërgatës nga Kosova.

Sabri Hamiti, duke u ndërlidhur me çështjet e diskutuara nga anëtarët e Komisionit, për inkurajimin e mërgimtarëve që të shkollohen në universitetet ku ata jetojnë, theksoi se është duke u përdorur një gjuhë iluministe e diskutimeve për diasporën dhe kjo çështje duhet trajtuar nga aspekti i bashkëpunimit dhe nga aspekti social.

Hamiti diskutoi edhe për çështjen e sjelljes së ekspertëve nga diaspora si dhe për çështjen e blerjes së librave për mërgimtarët, përmes tenderit. Sa i përket çështjes së investimeve në prodhim nga ana e mërgimtarëve, tha se ato mungojnë dhe pyeti se ku qëndrojnë problemet themelore të mërgimtarëve për të investuar në Kosovë. A është mungesa e legjislaturës së përshtatshme për investime, mos zbatimi i ligjeve apo problemi qëndron në sigurinë e investimeve të tyre.

Albin Kurti, kërkoi të informohet nga ministri, se si do të mund të realizohet ofrimi i ndihmës diasporës për krijimin e federatave, organizatave e shoqatave, për ngritjen e vetëdijes, për njohjen e rregullave dhe normave ligjore në shtetet ku ata jetojnë, se a është rritur numri i investimeve nga mërgata. Mbi çfarë baze ligjore është zgjedhë ushtruesi i detyrës së Qendrës në Stamboll dhe kërkoi ta ketë listën e titujve të librave të blerë për diasporën dhe nga kush është bërë përzgjedhja e tyre. Po ashtu, Kurti shtroi pyetjen se me rastin e mbajtjes së një tryeze me mjekët, si vazhdohet më tutje kjo çështje.

Ibrahim Makolli, njoftoi se titujt e librave janë përzgjedhur nga Divizioni për arsim plotësues dhe janë blerë përmes tenderit, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Lidhur me konferencën e

mjekëve, tha se ne ju kemi krijuar kontaktet, ndërsa më pas janë krijuar grupet punuese, të cilat i hartojnë planet e tyre të veprimit. Janë të organizuar brenda vetes dhe i marrin obligimet.

Lidhur me infrastrukturën ligjore për investime, Makolli tha se kemi identifikuar se një pjesë e tyre nuk zbatohet si dhe sa duhet.

Sa i përket udhëheqësit të Qendrës Kulturore në Turqi, njoftoi se është angazhuar një mërgimtar, i cili ka jetuar në Turqi nga vitet e 90-ta e këndeje, me kontratë mbi vepër, deri në zgjedhjen e kandidatit sipas konkursit.

Takimi përfundoi në orën 13:40.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit